



Fletë fashikulli për azilkërkues nga vende të sigurta prejardhjeje

Ju vini nga një "vend i sigurt prejardhjeje". Cilat vende janë të sigurta dhe çfarë do të thotë kjo për ju?

Aktualisht, vende të sigurta prejardhjeje janë:

Shqipëria, Algjeria, Andorra, Australia, Belgjika, Bosnja dhe Hercegovina, Brazilia, Bullgaria, Kanadaja, Qiproja, Danimarka, Gjermania, Estonia, Finlanda, Franca, Gjeorgjia, Gana, Greqia, Hungaria, Irlanda, India, Italia, Xhamajka, Japonia, Kosova, Kroacia, Letonia, Lihtenshtajni, Lituania, Luksemburgu, Maqedonia, Malta, Maroku, Monako, Mongolia, Mali i Zi, Holanda, Zelanda e Re, Norvegjia, Ukraina, Austria, Polonia, Portugalia, Rumania, San-Marino, Senegali, Serbia, Sllovenia, Sllovakia, Spanja, Togo, Trinidad dhe Tobago, Çekia, Tunizia, Qyteti i Vatikanit, Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara, Islanda, Suedia, Zvicra.

Kujdes! Kjo listë ndryshon vazhdimisht. Lista më aktuale mund të gjendet në:

www.rijksoverheid.nl/onderwerpen/asielbeleid/vraag-en-antwoord/lijst-van-veiligelanden-van-herkomst

Pushteti holandez këto vende i ka cilësuar si "vende të sigurta prejardhjeje". Situata në ato vende është mjaft e sigurt. Ju vini nga një vend i sigurt prejardhjeje. Prandaj ju nuk keni pothuajse asnjë gjasë për të marrë leje qëndrimi për azil në Holandë. Nëse kërkesa juaj për azil refuzohet apo tërhiqet, pushteti do t'ju caktojë ndalesë hyrjeje. Dhe ju kthen në vendin tuaj të sigurt prejardhjeje.

Procedura e azilit nëse vini nga një vend i sigurt prejardhjeje

Pas paraqitjes së kërkesës për azil, ju do të ndiqni një procedurë të përsheptuar azili. Organizata e interesit Shoqata Holandeze për Ndihmë të Refugjatëve (VWN) ju njofton lidhur me kërkimin e azilit në rast se vini nga një vend i sigurt. Ju do të zhvilloni një bisedë me Shërbimin për Imigracion dhe Natyralizim (IND). Një avokat do t'ju përgatisë për atë bisedë.

Në bisedën me IND-në ju mund të sqaroni se pse vendi juaj i prejardhjes nuk është i sigurt për ju. Nëse sqarimi juaj është i bindshëm procedura e përsheptuar do të mbyllet. Në atë rast IND-ja do ta vazhdojë shqyrtimin e kërkesës suaj sipas Procedurës së Përgjithshme të Azilit (AA). Në rast se sqarimi juaj nuk është i bindshëm, nga IND-ja do të merrni një "koncept për refuzimin e kërkesës tuaj për azil". Atë koncept ju mund ta diskutoni me avokatin tuaj. Nëse diskutimi juaj me avokatin nuk ia ndryshon mendimin IND-së? Atëherë IND-ja refuzon përfundimisht kërkesën tuaj të azilit. Dhe juve ju jepet ndalesë hyrjeje.

Shih anën e prapme

Çfarë do të thotë nëse ju jepet ndalesë hyrjeje?

Çfarë ndodhë nëse IND-ja refuzon kërkesën tuaj të azilit apo ju e tërhiqni kërkesën tuaj të azilit? Atëherë ju jepet ndalesë hyrjeje për 2 vjet. Ndalesë hyrjeje ju jepet vetëm azilkërkuesve të rritur. Në rast se nuk i përmbaheni ndalimit të hyrjes, bëheni objekt i dënimit. Ndalesa e hyrjes do të thotë se ju nuk keni të drejtë të shkoni apo qëndroni në: Holandë, Belgjikë, Bullgari, Qipro, Danimarkë, Gjermani, Estoni, Finlandë, Francë, Greqi, Hungari, Irlandë, Itali, Kroaci, Letoni, Lihtenshtajn, Lituani, Luksemburg, Maltë, Norvegji, Austri, Poloni, Portugali, Rumani, Slloveni, Sllovaki, Spanjë, Çeki, Mbretëri e Bashkuar, Islandë, Suedi dhe Zvicër.

Pasojat e refuzimit të kërkesës tuaj të azilit

E drejta juaj për strehim përfundon dhe ju jepet ndalesë hyrjeje. Ju duhet detyrimisht ta lëshoni Holandën. Shërbimi për Kthim dhe Largim (DT&V) mund t'ju shoqërojë për këtë. Ju mund të vendoseni në një Qendër me liri të kufizuar (VBL) apo Pikë Strehimi Familjar (GL). Të gjitha familjet me fëmijë të mitur shkojnë në një GL. VBL-ja dhe GL-ja janë për qëllim kthimi në vendin tuaj të prejardhjes. Ose ju vendosin në arrest për të huajt nëse pushteti mund t'ju dëbojë. Nëse nuk ju vendosin në VBL, GL apo në paraburgim? Atëherë ju duhet vetë ta lini Holandën. Kur ktheheni në vendin tuaj të sigurt të prejardhjes, në shumicën e rasteve nuk ju jepen aspak para kthimi. Kështu edhe në rast se e tërhiqni kërkesën tuaj për azil.

Pse azilkërkuesit nga vende të sigurta mund t'ia tregojnë më parë arsyet e tyre për azil IND-së?

Azilkërkuesit nga vende të sigurta vijjnë më herët në radhë për bisedë sepse gjasat janë shumë të mëdha se atyre nuk u jepet leje qëndrimi për azil. Ata zënë vende për strehim që janë paraparë për azilkërkues me gjasa të mëdha.

Çfarë ndodh me azilkërkues të cilët shkaktojnë shqetësime?

Pushteti holandez pret sjellje të mirë nga çdo i huaj, edhe nga ju. Ndaj azilkërkuesve (me procedurë të përfunduar) të cilët shkaktojnë shqetësime në qendra për strehim dhe rreth tyre mund të merren masa të menjëhershme. Për shembull: urdhërohet qëndrimi vetëm në një rajon të caktuar apo bëhet vendosja në arrest për të huajt. Gjithashtu është i mundshëm edhe dënimi me burgim.

Shihni për më tepër informacione në: www.ind.nl/asiel

Kjo shpallje është botim nga:

Shërbimi për Imigracion dhe Natyralizim (IND)

Nga përmbajtja e këtij botimi nuk përfitohet asnjë të drejtë. Në rast se përkthimi rezulton në dallime në interpretim, vendimtar do të jetë versioni në holandisht.